



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:201445

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05644565

KPPP.nr.1001/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbare të kreditorit Avokat Hamid Bula, me seli në rr. “Lidhja e Prizrenit”, nr.109, në Prishtinë, kundër debitorit “Italian Medical Group” L.L.C., me NUI: 810852469, me seli në rr. “Dëshmorët e Ponoshecit”, në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbare P.nr.386/21, të datës 17.06.2021, të Përmbaresit Privat Irfan I. Kërçagu, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 30.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Italian Medical Group” L.L.C, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbare P.nr.386/21, të datës 17.06.2021, i Përmbaresit Privat Irfan I. Kërçagu.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbare P.nr.386/21, të datës 17.06.2021, i lejuar nga Përmbaresi Privat Irfan I. Kërçagu.
- III. REFUZOHET si e pabazuar Ankesa për parregullsi e datës 13.05.2022 e paraqitur nga kreditori Avokat Hamid Bula.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Avokat Hamid Bula ka lëshuar urdhrin përmbare P.nr.386/21, të datës 17.06.2021, me të cilin ka lejuar përmbaremin,

në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës Nr. 01/052021, të datës 17.05.2021, me të cilën është detyruar debitori që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 4,095.52 €, deri në pagesën definitive të borxhit si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm, me përmbartimin e mjeteve monetare në llogaritë bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë e veçantë të përmbartuesit privat, si dhe me regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme deri në përmbushjen e kredisë së kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, duke theksuar ndër të tjerash se kreditori ka kërkuar shuma të pa mbështetura në Tarifën e Odës së Avokatëve, duke mos specifikuar shërbimet dhe kohën e ndërmarrjes së veprimeve dhe përpilimit të parashtresave apo akteve të ndryshme, por vetëm shumën në total prej 4,095.52 €, pa i specifikuar në mënyrë specifike shumat dhe veprimet që ka ndërmarr kreditori për debitorin. Ka shtuar se debitori ka qenë i gatshëm me kohë që ti paguaj kreditorit shumën reale për shërbimet e ofruara, mirëpo, i njëjti nuk ka qenë i gatshëm të pranoj. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri për përmbartim të anulohet si i pa bazuar dhe i pa lejuar.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, duke shtuar se debitori nuk i ka përmbushur të gjitha obligimet që rrjedhin nga fatura duke mbetur borxh shumën prej 4,095.52 €, i cili borxh dokumentohet edhe në bazë të faturës. Ka shtuar se e i njëjti ka ofruar shërbime për “Italian Medical Group” L.L.C., në procedurën penale ku procesi ka qenë me element të huaj dhe për këtë arsye edhe është tarifuar me ngritje prej 100 %. I ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzojë si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha

elementet e kërkuara dhe është e përshtatshme për përmbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm Faturën Nr. 01/052021 e datës 17.05.2021, e cila faturë i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura e lartcekur i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt me datën 24.05.2021, e cila vërtetohet nga Fletëkthesa e Postës e cila është nënshkruar nga ana e debitorit si dhe nuk është kontestuar asnjëherë nga debitori.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore, prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt i përmbarimit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të kreditorit të paraqitura në ankesën për parregullsi të datës 13.05.2022, duke iu referuar dispozitave të nenit 79 të LPP-së, gjeti se ankesa

për parregullsi e kreditorit është në tërësi e pabazuar, andaj të njëjtën e refuzoi dhe vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Në rastin konkret, kreditori përmes ankesës për parregullsi të datës 13.05.2022, ka deklaruar që me datën 06.05.2022, i ka parë duke qëndruar së bashku në një lokal përmbaruesin privat dhe debitorin, duke i propozuar gjykatës që të ndërpriten të gjitha veprimet lidhur me këtë çështje përmbarimore.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret, një kërkesë e tillë nuk gjen mbështetje ligjore në dispozitën e nenit 79 të LPP-së dhe rrjedhimisht e njëjta kërkesë është e pabazuar, meqenëse shkaqet për të cilat është paraqitur ankesa për parregullsi, nuk ndërlidhen me parregullsitë që janë kryer nga organi përmbarues gjatë kryerjes së procedurës së përmbarimit. Gjykata vlerëson se në rast se palët ndërgjyqëse kanë pasur dyshime në paanësinë e organit përmbarues, të njëjtit kanë mundur të kërkojnë përjashtimin e përmbaruesit, konform dispozitës së nenit 325 të LPP-së. Andaj meqenëse në rastin konkret, ankesa për parregullsi nuk është paraqitur për shkaqet e përcaktuara në dispozitën e nenit 79 të LPP-së, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 dhe 79 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1001/23, datë 30.04.2024

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komeriale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.